



OHËR: TAKIM ME DREJTORIN E AAC, SË MAQEDONISË SË VERIUT Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar z.Keri, ka zhvilluar një vizitë në Maqedoninë e Veriut me ftesë të homologut z. Tomislav Tunev... **faqe 2**



BRUKSEL: DREJTORI I AAC, Z. KRISLEN KERI MERR PJESË NË TAKIMIN E 22 TË (BANM) Në datën 11 Korrik në Bruksel u zhvillua takimi i radhës për BANM... **faqe 3**

GUSHT 2019 - Botimi XV

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



OPINION

KRISTA GARO

STUDIMI I ARKITEKTURËS SË HAPËSIRËS AJRORE NJË VIZION I QARTË DERI NË 2035

faqe 4

ANALIZA STATISTIKORE

QERSHOR 2019

Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza", shifrat tregojnë një numër prej 310,988 pasagjerësh të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Qershor për/nga TIA...

faqe 7-8

TRAJNIME

TIRANË: ZHVILLOHET KURSI I ICAO "SECURITY SUPERVISORS"

Në datat 16-25 Korrik pranë zyrave qendrore të Autoritetit të Aviacionit Civil u organizua kursi nga ICAO me temë mbi "Security Supervisors" me pjesëmarrje nga stafi i drejtorisë së Sigurisë në Aviacion në AAC, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave...

faqe 9



RAPORTI I PERFORMANCËS

Përmirësohet ndjeshëm performanca e kompanive ajrore që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" në vetëm 2 anulime dhe 4 vonesa me mbi 2 orë. Krahasuar me Korrikun e vitit të kaluar ku numri i vonesave dhe anulimeve ishte në nivele shumë të larta dhe shqetësuese, situata gjatë Korrikut të këtij viti është kthyer në nivele normale.

Shkaku i përmirësimit të situatës, kjo edhe në sajë të trysnisë së AAC, është marrja e masave nga kompanitë ajrore me avionë shtesë për të përballuar fluksin në rritje...

faqe 6

OHËR: TAKIM ME DREJTORIN E AAC, SË MAQEDONISË SË VERIUT

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar z. Krislen Keri, ka zhvilluar një vizitë në Maqedoninë e Veriut me ftesë të homologut z. Tomislav Tunev. Gjatë takimit, që u zhvillua në ambientet e Aeroportit të Ohrit, palët diskutuan për disa çështje të rëndësishme si menaxhimi i hapësirës ajrore mbi Liqenin e Ohrit, e cila përdoret nga pala maqedonase për avionët që fluturojnë nga ky aeroport, për të vijuar me koordinimin e punëve për shkëmbime ekspertize për zhvillimin e aktiviteteve mbikëqyrëse të entiteteve ajrore të dy vendeve, mundësinë e zhvillimit të trajnimeve të përbashkëta etj. Keri mirëpriti nismën për të zhvilluar një forum të përbashkët rajonal, dhe ku Autoritetet e gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor të adresojnë problematikat e përbashkëta për të përmirësuar eficientësinë dhe shërbimin ndaj qytetarëve. Sipas Kerit, krijimi i një formati rajonal do të ndikonte pozitivisht edhe në organizmat e rëndësishme europiane si EASA, për të adresuar çështje me




Në foto:
Drejtori i AAC së Shqipërisë, z. Krislen Keri dhe homologu i Maqedonisë së Veriut, z. Tomislav Tunev gjatë vizitës në ambientet e Aeroportit të Ohrit

interes të përbashkët. Ndërsa z. Tunev vlerësoi AAC si një institucion që ka ndërmarre hapa shumë pozitivë, në përmirësimin e performancës dhe kontributit në aviacionin civil kombëtar dhe rajonal, duke u ndalur në veçanti me organizimin e trajnimeve të rëndësishme në bashkëpunim me ICAOn dhe JAA. Pas vizitës në Aeroportin e Ohrit,



Në foto:
Drejtori i AAC së Shqipërisë, z. Krislen Keri dhe homologu i Maqedonisë së Veriut, z. Tomislav Tunev gjatë vizitës në ambientet e Aeroportit të Ohrit

Keri tha se një potencial të madh dhe të ngjashëm në rajon do të ketë edhe Aeroporti i Kukësit, që pritet të ketë impakt shumë pozitiv në turizëm dhe në ekonomi, dhe ftoi përfaqësuesit e këtyre dy aeroporteve të fillonin një bashkëpunim me qëllim shkëmbimin e ekspertizës së ndërsjellët dhe më gjerë. Dy zyrtarët koordinuan edhe bashkëpunimin në forumet e ardhshme të aviacionit, ku mbajtja e qëndrimeve si rajon do të ishte më efektive dhe e dobishme.



BRUKSEL: DREJTORI I AAC KRISLEN KERI MERR PJESE NË TAKIMIN E 22 PËR NORMALIZIMIN E AVIACIONIT NË BALLKAN (BANM)

Në datën 11 Korrik u zhvillua takimi i radhës për normalizimin e aviacionit në Ballkan njohur si BANM me pjesëmarrjen e Drejtorit Ekzekutiv të AAC-së. Ky takim organizohet nga

NATO për të kontribuar në stabilitet rajonal, siguri dhe zhvillimin ekonomik për rajonin e Ballkanit Perëndimor.



Në foto:

Bruksel-Belgjikë Pamje nga zyrat qendrore të NATO-s ku u zhvillua takimi i BANM.



STUDIMI I ARKITEKTURËS SË HAPËSIRËS AJRORE – NJË VIZION I QARTË DERI NË 2035

Projektimi dhe përdorimi i Hapësirës Ajrore

Opinion - Krista Garo

Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë mbi komunikimin e Komisionit Evropian mbi “Një Strategji Aviacioni për Evropën”. Rezoluta “rikujton se hapësira ajrore është gjithashtu pjesë e tregut e përbashkët të BE-së, dhe se çdo copëzim që vjen nga përdorimi i tij joefikas, si dhe praktikatat divergjente kombëtare” shkakton kohë më të gjatë fluturimi, vonesa, djegie shtesë të karburantit dhe nivele më të larta të emetimeve të CO². Në këtë kontekst, Parlamenti Evropian ftoi Komisionin të nisë një projekt pilot në arkitekturën e hapësirës ajrore “Qielli i Përbashkët European” (SES). Kjo bëri që Eurocontrol nëpërmjet projektit të Përbashkët SESAR, në bashkëpunim me Menaxherin e Rrjetit EUROCONTROL, me nisjen dhe menaxhimin e studimit të Arkitekturës së Hapësirës Ajrore, të theksojë nevojën për të siguruar përputhshmëri me objektivat e projektit SESAR dhe, veçanërisht vizionin e zhvilluar në Master Planin Evropian të ATM-ve. Propozimi për Arkitekturën e ardhshme të Hapësirës ajrore të lëshuar në 5 Mars 2019 përcakton se si duhet të duket arkitektura e hapësirës ajrore të Evropës në planin afatmesëm

deri në atë afatgjatë (2025-2035), dhe cilat hapa praktikë do të duheshin ndërmarrë për ta bërë atë realitet. Sistemi i së ardhmes është një shërbim i orientuar që bazohet në teknologjitë digjitale, mbështet në mënyrën e duhur flukset e trafikut në rrugë ajrore dhe ndihmon në optimizimin e mënyrës se si ofrohen shërbimet e lundrimit ajror. E gjithë kjo do të mbështetet nga një infrastrukturë e përparuar ATM / CNS që pasqyron plotësisht vizionin e SES për 2035, me objektiva rritjen e performancës për sigurinë, kapacitetin, ndikimin në mjedis dhe efikasitetin e fluturimit. Menaxheri i Rrjetit të EUROCONTROL dhe kontributin e tij në të gjitha aspektet e operacionit që lidhen me studimin, veçanërisht hartimin e hapësirës ajrore, përsosmërinë operative dhe vlerësimet e performancës operacionale. Zbatimi i Studimit të Arkitekturës së Hapësirës Ajrore do të ndihmojë në kthimin e numrit të vonesave në përputhje me objektivin e SES dhe të përfitimeve shtesë, të realizuara përmes rritjes së produktivitetit të shërbimit të lundrimit ajror dhe një rënie të konsiderueshme të ndikimin e aviacionit në ndotjen mjedisore.




AIR ALBANIA: GATI FLUTURIMET ME DESTINACION ITALINË

Air Albania vazhdon të konsolidohet si kompania flamurbajtëse e vendit. Lajmin e ka dhënë kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama përmes një postimi në rrjetet sociale duke theksuar se linja e re fillon pas pak javësh dhe do të jetë me destinacion në disa qytete të Italisë. Më poshtë postimi i plotë.

"Pas "Lasgushit" qëmbulon Stambollin, ja edhe "Migjeni", avioni i dytë i flotës së Air Albania që do të fluturojë në fillim vjeshtë drejt Italisë Boeing 737 i vitit 2016, me shërbim të standarteve të larta nga trupa shqiptare e stjuartëve, që nga ushqimi në bord që ishte harruar prej shumë vitesh për udhëtarët e Rinasit dhe me televizor për çdo pasagjer, si asnjëherë më parë Tani vazhdoni shani e përqeshni që mos na marrin më sysh, ndërkohë që "Naimi" do t'i shtohet flotës në fund të vitit për destinacione të tjera europiane dhe më tej, do të vijë "Noli" për linjën direkte Shqipëri-Amerikë. Më tutje do të vazhdojë zgjerimi i flotës me të tjerë, bazuar mbi suksesin e fazës së parë, po më mirë i'a lemë kohës të na tregojë e të flasë Se gur gur bëhet muri dhe mur pas muri bëhet kalaja thotë Populli; po normal që çdo popull ka të paduruarit e të pagdhendurit e vet, kështu që rroftë puna se ajo mbetet, ndërsa llafet lum kush i duron deri kur t'i marrë era".



Aviacioni Civil gjithashtu ka miratuar lejen për 2 avionë të Air Albania që do të fillojnë operimet së shpejti.



Në foto:
pamjet e publikuara të avionit nga postimi në rrjetet sociale të kryeministrit të Shqipërisë z. Edi Rama



Në foto:
fjala e drejtorit të Aviacionit Civil Krislen Keri, për Çertifikimin e kompanisë ajrore "AirAlbania"

RAPORTI I PERFORMANCËS:

PERFOMANCA E KOMPANIVE AJRORE PËR MUAJIN KORRIK

Përmirësohet ndjeshëm performanca e kompanive ajrore që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar Nënë Tereza. Krahësuar me Korrikun e vitit të kaluar ku numri i vonësive dhe anulimeve ishte në nivele shumë të larta dhe shqetësuese, situata gjatë Korrikut të këtij viti është kthyer në nivele normale. Nga të dhënat e ardhura nga sektori për Të Drejtat e Pasagjerit në TIA rezultojnë se gjatë gjysmës së dytë të muajit Korrik 2019, ka pasur 2 anulime fluturimi, njëra nga kompania "Transavia" në aeroportin e Amsterdemit si pasojë e bllokimit të sistemit të furnizimit me karburant të avionëve në aeroportin e Amsterdemit (ku në këtë rast janë anuluar shumë fluturime për/nga ky aeroport), si edhe anulimi i fluturimit të kompanisë "Alitalia" për shkak të grevës së transportit ajror në Itali. Fluturimi i "Wizz Air" për nga Tirana drejt aeroportit të Luton-it në Londër pati një vonesë të gjatë për shkak operacionale dhe kompania "Blue Panorama"



pati një vonesë shumë të gjatë në datën 28 Korrik për shkak të një defekti teknik. Shkaku i përmirësimit të situatës kjo edhe në sajë të tryknisë së AAC, është marrja e masave nga kompanitë me avionë shtesë për të përballuar fluksin në rritje.




ANALIZA STATISTIKORE



TË DHËNAT PËR NUMRIN E PASAGJERËVE GJATË MUAJIT QERSHOR

QERSHOR 2019: Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, shifrat tregojnë një numër prej 310,988 pasagjerësh të cilët kanë udhëtuar gjatë muajit Qershor për/nga TIA. Grafiku i mëposhtëm paraqet zotërimin e tregut të transportit ajror nga secila kompani, në përqindje për muajin Qershor 2019. Ajo që bie në sy është rritja për kompaninë Air Albania.




Grafiku 1: zotërimi i tregut të numrit të pasagjerëve në %, sipas kompanive ajrore që kanë udhëtuar për/nga TIA gjatë muajit Qershor 2019

PËRQINDJET: Bazuar në të dhënat e mësipërme, kompania ajrore “Ernest S.p.A” është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Qershor 2019, me një numër prej 50,765 pasagjerësh ose 16% të totalit. Ndjekur nga Blue Panorama me 14% ndaj totalit dhe 44,127 pasagjerësh. Fluturimet charter këtë muaj zënë 16% të tregut me një numër prej 50,571 pasagjerësh. Sikurse mund të shihet edhe në grafik, kompanitë që fluturojnë drejt Italisë zotërojnë përqindjen më të madhe në tregun e transportit ajror për muajin Qershor 2019, me një numër pasagjerësh prej 140,640 dhe 46% të totalit. Për sa i përket fluturimeve charter të cilat zënë 16% të tregut, destinacionet janë të shumta.


ANALIZA STATISTIKORE

■ **QERSHOR 2018** Nëse do të bënim krahasimin e tre viteve të fundit, trafiku ajror dhe fluksi i pasagjerëve këtë vit, gjatë Qershorit të 2019 ka një rritje prej 12% krahasuar me vitin e kaluar.

Tabela 1:
Numri i pasagjerëve për muajin Qershor përgjatë viteve 2017, 2018, 2019



Për sa i përket rritjes/rënies së fluksit të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Qershor 2017-2018-2019, vëmë re se kompania "Lufthansa" ka pasur një rritje prej 103% duke u pasuar nga "Ernest Airlines" e cila shënon rritje prej 90% të numrit të pasagjerëve krahasimisht me një vit më parë. Fluturimet Charter kanë shënuar rritje prej 14 % krahasimisht me vitin 2018 ku numri i pasagjerëve ka qenë 108% më i lartë se në vitin 2017. Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin e numrit të pasagjerëve në muajin Qershor 2019 kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2018 dhe 2017:



Grafiku 2:
Numri i pasagjerëve për muajin Qershor 2017, Qershor 2018, Qershor 2019 sipas operatorëve ajrorë.

TIRANË: ZHVILLOHET KURSI ICAO "SECURITY SUPERVISORS"

Në datat 16-25 Korrik pranë zyrave qendrore të Autoritetit të Aviacionit Civil u organizua kursi nga ICAO me temë mbi "Security Supervisors" me pjesëmarrje nga stafi i drejtorisë së Sigurisë në Aviacion (DSA) në AAC, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë,

Albcontrol dhe Shërbimi Informativ Shtetëror. Ky kurs kishte për qëllim trajnimin e mbikëqyrësve të sigurisë në aviacion në lidhje me masat parandaluese, procedurat operacionale, efikasitetin e pajisjeve të sigurisë.



Në foto:

foto përmbyllëse e drejtorit të AAC, z. Keri së bashku me trajnuesit, inspektorët e AAC dhe stafi i pjesëmarrësve nga institucionet e tjera të pranishëm në trajnimin e pranë zyrave qendrore të AAC.

VIZITË VLERËSUESE E PËRFAQËSUESVE TË "TSA" Përgjatë datave 30-31 Korrik me pjesëmarrje nga US Transportation Security Administration u organizua *on site visit* në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza". Kjo vizitë kishte për qëllim vëzhgimin e implementimit të masave të sigurisë në aviacion si dhe përputhshmërinë e tyre me Aneksin 14 dhe 17 të Organizatës Botërore të Aviacionit Civil si dhe Standardet dhe Praktikën e Rekomanduara. Gjatë vizitës në zyrat e AAC, ekspertët e TSA u shprehën pozitivisht për punën e kryer nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar dhe rekomanduan disa pika orientuese për në vazhdim.



Në foto:

Gjatë vizitës në zyrat e AAC, ekspertët e TSA dhe z. Krislen Keri.